

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Përgjegjës i Sektorit të Financës

Ne baze të ligjit të Agjencisë të Trajtit të Kredive dhe rregullores së saj

Kërkesat e veçanta për perzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar ;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së presë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- të ketë kryer studimet e larta , të nivelit Master Shkencor në Shkencat Ekonomike;
- të ketë përvojë pune me shume se 3 vit në administratën publike ose përvojë drejtuese në sektorin privat;
- të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office, Financa 5;
- zotërimi i një gjuhe të huaj përben avantazh;
- të ketë aftësi të mira drejtuese, menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Përgjegjësitë

Detyrat e Përgjegjësit të Sektorit të Financës :

- Është përgjegjës për drejtimin e kontrollin e realizimit të detyrave nga specialistët e Sektorit të Financës;
- Drejton punën në lidhje me veprimet për kontabilizimin, rakordimin dhe kontrollin për çdo muaj të llogarive bankare që ka institucioni në bankat e nivelit të dytë.
- Siguron një bashkëpunim dhe koordinim efikas midis strukturës së Sektorit të Financës dhe strukturave të tjera në institucion, në mbështetje të realizimit të planit të arkëtimit dhe zbatimit të shpenzimeve buxhetore sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
- Thërret në raport punonjësit në varësi të tij, për probleme të veçanta, sidomos kur ka mangësi në sistemin raportues, në përdorimin e shpenzimeve të miratuara, të inventarit në ngarkim
- Çdo fund muaj raporton në mënyrë të detajuar për veprimtarinë e sektorit që drejton.
- Përgatit konform rregullave financiare në fuqi mandat- arkëtimet, mandat-pagesat dhe urdhër-xhirimet.
- Mban llogarinë e investimeve, makinerive, paisjeve, mjeteve të transportit, etj., dhe kryen veprimet kontabile të këtyre llogarive
- Llogarit amortizimin e mjeteve kryesore të institucionit sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
- Nxjerr të dhëna për arkëtimet e debitorëve dhe shpenzimeve buxhetore.
- Konfirmon vërtetimet për mbylljen e detyrimit të debitorëve.
- Kryen kontabilizimin e dokumentave të arkës dhe bankës të kredimarrësve.

- Përgatit dhe kontrollon List-Pagesën e punonjësve
- Përgatit raportit statistikor periodik.

Procedurat e Përgjithshme të Aplikimit :

Aplikimi duhet të përmbajë:

- Kërkesë me shkrim
- Curriculum vitae
- Libreza e punes
- Dëshmi Penaliteti

Aplikimet duhet të dërgohen në zarf të mbyllur duke specifikuar pozicionin në adresën:

Agjencia e Trajtimit të Kredive

Njësia Administrative nr.13, Selitë – Tiranë, Rruga “Rrapo Hekali”, Ndërtesa 21. Kodi 2084021

Afati

Aplikimet prahen deri në datën 14 Tetor 2022 , ora 12:00. Do të shqyrtohen vetëm ato aplikime që mbërrijnë brenda këtij afati. Pas vlerësimit të dokumentave vetëm kandidatët e suksesshëm do të ftohen për intervistë.